



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odseljenje za Opštu Upravu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

-III- Nr. i prot. 79 Më Dt. 14.01 2021
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac
Municipality of Rahovec

PËR (ZA) TO:	Kryetarin e Komunës: z.Smajl Latifi Drejtoresh e administrates Komunale: znj.Saranda Sallteku/
PËRMES(PREKO)THROUGH	
NGA (OD) FROM	Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut - Habibe Haxhimustafa
LËNDA	Raporti i punës/ Janar – dhjetor 2020:
Data	15.12.2020

Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punët nga NJKDNJ:

*Kemi mbajtur një trajnim me Grat dhe vajzat që kanë përfunduar shkollimin dhe kërkojnë punësim –Shkolla e mesme Xhelal Hajda –Toni dhe Krushë e Madhe me Temen .:, Qasja e të rinjëve për punësim’’

* Pas një pune të gjatë që bëmë me disa grate e dhunuar gjatë luftës duke i ndihmuar në Aplikacione për Komisionin Qëndror deri tani na kanë njoftuar se 4 personave(të dhunuara) ju ka njoftuar statusin dhe tani do të jenë të kompenzuar nga 230€ në muaj nga muaji prill.

* Janë mbajtur 2 takime të rregullta dita e hapur me qytetarë me keshilltarin e lartë juridik të Avokatit të popullit , edhe pse është dahtë çdo muja të mbahen takime me qytetarët për shkak të pandemis nuk janë mbajtur.

*Janë mbajtur dy takime me Komisionin Komunal për Ri-atdhesim –

*Pas trajnimit për Platformën për të Drejtat e Njeriut – me kërkesën e MAPL-s kemi aritur ta hapim linkun në web faqen e Komunës ku do të lehtësohet puna e gjithë stafit të komunës , sidomos zyrës Ligjore me përdorimin e kësaj platforme.

* Pjesëmarrje në panel për 27 vende pune me kontratë mbi vepër.

Me projektin e Ri-atdhesimit përfundojnë 3 shtëpitë që ishin duke u ndërtuar gjatë vitit 2019 , gjithashtue këta edhe janë pais me mobile dhe teknik të bardhë :

- 1.Zhaerzino Rustemi- I komunitetit Rom
2. Reshat Hamza - I komunitetit Rom
- 3.Latif Zena – I komunitetit Shqipëtar

Pas një pauze nga virusi COVID 19 gjendja filloj të stabilizohet dhe filluam punën si zakonisht

- Si Kryetare e Komisionit Komunal mbajtëm dy mledhje me anëtarët e Komisionit dhe shqytuam Kërkesën e një Nene vetushqyese për ndihmë dhe Akomodim, e cila ishte jashtë kriterit nga Rregullorja 13/2017 e cila është në fuqi por duke u bazuar në sistemin e krijuar nga Pandemia COVID 19 Komisioni Komunal për Ri-atdhesim në seancën e mbajtur më 04.06.2020 njëzërit Apropoj Kërkesën për Akomodim nga data 01.05.2020 deri 31.10.2020 në vlerë 280€ dhe 08.10.2020 kësaj

nëne vetushqyese Komisioni ia vazhdon Kontraten edhe për 6 muaj të tjera me projektin e Ministris së Punëve të Brendshme sektori për Ri-atdhesim.

- Planet e Biznesit – gjatë vitit 2020 janë aprovuar 5 Planet e Biznesit për mjete pune në vlerë 3000 €, për një Plan Biznesi.
- Është aprovu edhe Plani Komunal I Veprimit në Kuvend për personat e Ri-atdhesuar

Barazia Gjinore

Aktivitetet e përmbushura nga Plani Vjetor i Punës

Edhe pse situata me pandemin COVID-19 na ka pamundesuar që ti realizojmë disa aktivitete prap se prap disa prej tyre janë realizuar sipas planit vjetor.

- Duke u bazuar në disa objektiva që i kam të planifikuar për realizim të aktiviteteve gjatë gjithë vitit për zbatim, monitorim dhe raportim mbi zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi promovimin dhe përhapjen e vlerave në fushën e të drejtave të njeriut e në veqanti të gruas si dhe fuqizimi, integrimi i saj në jetën shoqërore e poashtu edhe bashkëpunim për formimin e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje, me të gjitha institucione dhe me OJQ-të dhe organizata e ndryshme vendor dhe ndërkombëtare.

Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, nëpër institucione e Kuvendit Komunal, komisione, komitete gjatë tërë vitit.

- 8 Marsi – Dita ndërkombëtare e Gruas është shënuar me një grup të grave të punësuar në institucione të ndryshme.

Janë realizuar disa aktivitete që kanë patur për qëllim promovimi e trashëgimise dhe pronës së gruas me gra, vajza dhe me nxënës të shkollës së mesme këtu në Rahovec në bashkëpunim me OSCE-n.

Poashtu në bashkëpunim me Agjensionin për Barazi Gjinore janë realizuar disa takime dhe tyreza të ndryshme me qëllim të fuqizimit të gruas dhe lëvizjes për para të problematikës së barazise gjinore.

dhe për funksionalizimi të çerdhës, si takimi me Kryetarin dhe me asamblesitet e Komunës me aktor të ndryshëm komunal. Ku si rezultat kemi arritur që të fillojnë punimet për çerdhës në fshatin Ratkoc, Xërxe, Krushe e Madhe.

Për të promovuar një shoqëri pa dhunë në familje në baza gjinore dhe me të drejta të barabarta në bashkëpunim me të mbështetur nga OJQ-Hareja dhe OSCE-a, dhe Komuna.

Gjatë muajit tetor me qëllim të senzibilizimit kundër kancerit të gjirit është realizuar një ligjerat për gratë dhe vajzat e Komunës sonë në bashkëpunim me Grupin Formal të Grave, Drejtorin për Shëndetësi, OJQ-n Hareja, në Lokalet e Qendres Hareja.

Ku është bërë hapja e fushatës dhe senzibilizim i qytetareve përmes takimeve të mabjatura nëpër shkollat e Komunës sonë për vetedijesimin e grave që të jenë pjesë e keshillave Lokale të lagjeve dhe Fshatrave.

- Mbajta e tryezës për planifikimin e Buxhetimit Gjinior 2021-2023. Por për shkak të pandemisë Covid-19 nuk është or

Vendimet në Komisione:

1. Zytari për Barazi Gjinore ka marrë pjesë në Komision të ndryshme: si antar i komisionit për performancë komunale, për transparencë komunale, si dhe vendime të ndryshme në rekrutim të stafit civil etj